

EPPC Albania kërkon një **Shef/e Finance** për klientin e saj, një ndër **kompanitë më të mëdha dhe të konsoliduara në vend në prodhim.**

Përgjegjësitë Kryesore:

- Menaxhon, koordinon dhe kontrollon të gjitha operacionet financiare të kompanisë;
- Kontrollon dhe supervizon stafin e financës, si dhe siguron një performancë të tyre në punë;
- Menaxhon Kontabilitetin dhe Financat e kompanisë, duke siguruar performancë të mirë të funksionit të përgjithshëm të kontabilitetit;
- Përgatit pasqyrat financiare, raportet financiare, analiza speciale, dhe raportet informative;
- Menaxhon, koordinon dhe kontrollon të gjitha aktivitetet me palët e treta të lidhura ngushtë me çështjet financiare të kompanisë;
- Analizon pasqyrat financiare për të identifikuar fushat e mundshme të dobëta;
- Harton dhe implementon politika dhe procedura financiare për tu respektuar nga kompania.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Financë-Kontabilitet;
- **Eksperiencë pune në pozicione drejtuese në financë-kontabilitet (e preferueshme në prodhim);**
- **Të zotërojë shumë mirë Alpha** ose programeve të tjera financiare;
- Aftësi të mira drejtuese, organizative, analitike dhe vendimmarrëse;
- **Të jetë i/e disponueshme për të udhëtuar jashtë Tirane;**
- Të karakterizohet nga integriteti, korrektësia dhe ndershmëria në punë.

Të dhënat:

Pozicioni:	Shef/e Finance;
Vendndodhja:	Tiranë;
Udhëtime pune:	Po, brenda vendit;
Pagesa:	Në nivel drejtues;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	18.09.2018.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

tianda.nano@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.